





EDUKIMI MJEDISOR



MARS 2026

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

Mbrojtja e mjedisit ka të bëjë me mirë-përdorimin e tokës dhe të burimeve të saj për të mirën afatgjatë të njerëzve.
Gifford Pinchot

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndër marrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale përgjatëmuajit mars 2026.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë 1 282

56 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar 24

64 Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara 56



“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



12 Mars 2026 – Dita Botërore “Mbill një lule”

Veprimet konkrete si mbjellja e luleve dhe pastrimi i mjedisit kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë qytetare për mbrojtjen e natyrës. Specialistët e ADZM Shkodër, në bashkëpunim me Shoqatën Cukali dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Gjergj Vat Martini”, zhvilluan një orë të hapur mjedisore në ambientet e Qendrës së Vizitorëve.

Gjatë aktivitetit u zhvillua një bisedë mbi rëndësinë e ditës dhe kujdesin ndaj luleve, më pas u realizua mbjellja e disa luleve si veprim simbolik për dashurinë ndaj natyrës. Gjithashtu, nxënësit morën pjesë në një aksion pastrimi rreth Qendrës së Vizitorëve dhe zhvilluan një vizitë informuese brenda saj, duke u njohur me rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe zonave të mbrojtura.

ditë botërore ligatinat edukim mjedisor
natyrë angazhim



“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



5 mars 2026 - Mbetjet dhe ndikimi i tyre në natyrë

Mbetjet urbane përbëjnë një nga faktorët kryesorë të ndotjes së mjedisit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në ekosistemet natyrore. Në shkollën “Kamber Bënja”, Këlcyrë, me nxënësit e klasës së dytë u zhvillua një orë mjedisore nga specialistët e AdZM Gjirokastrë me temë “Mbetjet dhe ndikimi i tyre në natyrë”. Përmes kësaj ore nxënësit u ndërgjegjësuam se çdoveprim i vogël ka rëndësi, duke mësuar të mos hedhin mbeturina pa kriter dhe të praktikojnë ripërdorimin dhe riciklimin.

9 Mars 2026 - Dita e Veprimit për Lumenjtë

Lumenjtë janë burime jetike për natyrën, biodiversitetin dhe komunitetin njerëzor, ndaj mbrojtja e tyre është thelbësore. Në shkollën 9-vjeçare “Kamber Bënja”, Këlcyrë, me nxënësit e klasës së dytë u zhvillua një orë mjedisore nga specialistët e AdZM Gjirokastrë në kuadër të Ditës së Veprimit për Lumenjtë. Gjatë aktivitetit nxënësit mësuan për rëndësinë e lumenjve dhe diskutuan mënyrat e mbrojtjes së tyre nga ndotja.

12 Mars 2026 – Dita Botërore “Mbill një lule”

Veprimet e vogla mjedisore si mbjellja e luleve kontribuojnë në edukimin e fëmijëve përdashurinë dhe kujdesin ndaj natyrës. Në kopështin “Dervician”, Gjirokastrë, AdZM Gjirokastrë bashkëpunim me institucionin zhvilluan një aktivitet krijues dhe ndërgjegjësuës me fëmijët parashkollorë. Fëmijët morën pjesë në aktivitete kreative dhe mbollën lule në oborrin e kopshtit, duke mësuar rëndësinë e kujdesit për mjedisin dhe natyrën.

ditë botërore pyje

orë mjedisore fauna e egër



18 mars 2026 - Fauna e egër



Njohja e faunës së egër ndihmon në zhvillimin e respektit dhe kujdesit për ekosistemet natyrore. Në kopështin "Cicërimat", Gjirokastër, AdZM Gjirokastër zhvilloi një orë mjedisore me temë "Fauna e egër", ku fëmijët parashkollorë u angazhuan në krijimin e një mini-pylli me figurakafshësh dhe materiale kreative. Aktiviteti nxiti imagjinatën, bashkëpunimin dhe dashurinë përnatyrën.

19 mars 2026 - Ardhja e lejlekut

Shpendët shtegtarë si lejleku janë një pjesë e rëndësishme e ekosistemit dhe sinjal i ndryshimeve në natyrë. Në kopështin "Cicërimat", Gjirokastër, AdZM Gjirokastër zhvilloi një aktivitet edukativ dhe krijues me fëmijët parashkollorë mbi jetën e lejlekut. Fëmijët u njohën me udhëtimet e tij dhe rolin në natyrë, duke realizuar punime artistike që forcuan lidhjen e tyre me mjedisin.

22 Mars 2026 - Dita Botërore e Ujit

Uji është një burim jetik për jetën dhe ruajtja e tij është përgjegjësi e përbashkët. Në shkollën "Nonda Bulka", Këlcyrë, me nxënësit e klasës së 4-t u zhvillua një orë mjedisore nga specialistët AdZM Gjirokastër në kuadër të Ditës Botërore të Ujit. Nxënësit mësuuan për rëndësinë e ujit dhe ciklin e tij në natyrë, duke u ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e kursimit dhe mbrojtjes së tij.

26 mars 2026 - Pemët dhe rëndësia e tyre

Pemët luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe cilësisë së jetës. Në shkollën "Kamber Bënja", Këlcyrë, AdZM Gjirokastër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së dytë me temë "Pemët dhe rëndësia e tyre". Nxënësit mësuuan për vlerën e pemëve dhe rëndësinë e mbrojtjes dhe mbjelljes së tyre për një mjedis më të gjelbër.

27 mars 2026 – Orë mjedisore

Riciklimi është një proces i rëndësishëm për reduktimin e ndotjes dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Në shkollën "Andon Zako Çajupi", Gjirokastër, AdZM Gjirokastër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 3-të me temë "Riciklimi". Nxënësit u angazhuan në ndarjen e mbetjeve sipas koshave me ngjyra dhe krijuan fletëpalosje me mesazhe ndërgjegjësuese përmbrojtjen e mjedisit.



“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



3 Mars 2026 - Dita Botërore e Jetës së Egër

Jeta e egër në zonat e mbrojtura përbën një pasuri të rëndësishme natyrore që kërkon mbrojtje dhe ndërgjegjësim të vazhdueshëm. Në shkollën 9-vjeçare “Myslim Shehu”, klasa e 6-të, AdZMDibër zhvilloi një orë mjedisore me 15 nxënës në kuadër të kësaj dite. Përmes lojërave edukative, puzzle-ve dhe aktiviteteve krijuese, nxënësit u njohën me habitatin, ciklin jetësor dhe rëndësinë e mbrojtjes së specieve të jetës së egër.

12 Mars 2026 - Dita Botërore “Mbill një lule”

Bimët dhe lulet luajnë një rol të rëndësishëm në ekuilibrin natyror dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit. Në Shkollën e Bashkuar “Gjergj Kastrioti”, Baz, AdZM Dibër në bashkëpunim me nxënësit e klasës së 7-të zhvilloi një orë mjedisore me temë “Mbill një Lule”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe kontribuan përmes krijimeve artistike që pasqyrojnë kujdesin ndaj natyrës.

13 Mars 2026 - Cikli jetësor i kafshëve

Lumenjtë janë burime jetike për ekosistemet dhe komunitetet, ndaj mbrojtja e tyre është thelbësore. Në shkollën 9-vjeçare “Kurt Cakoni”, Baz, klasa e 7-të, AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore mbi rëndësinë e ruajtjes së lumenjve dhe mbrojtjen e tyre nga ndotja. Nxënësit shprehën idetë e tyre përmes punimeve kreative mbi lumenjtë e pastër dhe të gjallë.

orë mjedisore ndërgjegjësim

biodiversitet mjedis i pastër





18 Mars 2026 - Dita Botërore e Riciklimit

Riciklimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve janë thelbësorë për mbrojtjen e mjedisit. Në shkollën 9-vjeçare "Haki Stërmilli", Melan – Peshkopi, AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me temë "Tre R-t". Nxënësit u njohën me rëndësinë e produkteve të riciklueshme dhe procesin e riciklimit, duke krijuar ilustrime dhe materiale ndërgjegjësuese.

19 Mars 2026 - Dita Botërore e Pyjeve

Pyjet janë një nga ekosistemet më të rëndësishme për jetën në Tokë dhe kërkojnë mbrojtje të vazhdueshme. Në shkollën 9-vjeçare "Haki Stërmilli", Melan – Peshkopi, AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore mbi rëndësinë e pyjeve. Nxënësit u njohën me rolin e tyre në mjedis dhe shprehën njohuritë përmes vizatimeve dhe punimeve artistike.

30 Mars 2026 - Dita Botërore "Mbill një lule"

Menaxhimi i mbetjeve dhe reduktimi i tyre janë thelbësorë për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Në shkollën 9-vjeçare "Papa Gjon Pali II", Ulëz, AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me temë "Kategorizimi i Mbetjeve", me nxënësit e klasës së 9-të. Nxënësit u angazhuan në aktivitete praktike dhe krijuan modele të koshave të diferencuar për mbetjet, duke forcuar ndërgjegjësimin për riciklimin.

“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



flora në zonat e mbrojtura edukim mjedisor
biodiversitet fauna e egër



3 Mars 2026 - Dita Botërore e Jetës së Egër

Jeta e egër dhe ruajtja e habitateve natyrore janë thelbësore për ekuilibrin e ekosistemeve dhe kërkojnë ndërgjegjësim të vazhdueshëm. Në shkollën 9-vjeçare “Sali Llanaj”, fshati Velešnjë, Berat, specialistët e AdZM Berat zhvilluan një orë mjedisore me temë “Dita Botërore e Jetës së Egër”. Gjatë aktivitetit u diskutua rëndësia e mbrojtjes së specieve të egra dhe përgjegjësia që secili ka ndaj mjedisit. Në përfundim, në ambientet e shkollës u mbollën disa fidane si simbol i angazhimit për gjelbërimin dhe mbrojtjen e natyrës.

12 Mars 2026 - Dita Botërore “Mbill një lule”

Lulet dhe gjelbërimi janë elementë të rëndësishëm për edukimin mjedisor dhe zhvillimin e ndjenjës së kujdesit ndaj natyrës. Në ambientet e AdZM Berat, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Maj”, u zhvillua një orë mjedisore me temë “Mbill një lule”. Nxënësit u angazhuan në aktivitete kreative dhe shprehën dashurinë për natyrën përmes vizatimeve me temë mjedisore dhe lule. Në përfundim, ata mbollën simbolikisht një lule në ambientet e institucionit, duke dhënë një shembull pozitiv të kujdesit për mjedisin.

18 Mars 2026 - Dita Botërore e Riciklimit

Riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve janë thelbësore për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjes. Në shkollën 9-vjeçare “Molisht”, Berat, specialistët e AdZM Berat zhvilluan një orë mjedisore në kuadër të Ditës së Riciklimit. Nxënësit u njohën me mënyrat e ndarjes së mbetjeve, rëndësinë e riciklimit dhe rolin e tyre në ruajtjen e natyrës. Në përfundim të aktivitetit, së bashku me nxënësit u mbollën disa fidane në ambientet e shkollës, duke kontribuar në gjelbërimin e mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



3 Mars 2026 -Dita Botërore e Jetës së Egër

Jeta e egër në zonat e mbrojtura përbën një pasuri të çmuar natyrore dhe kërkon ndërgjegjësim të vazhdueshëm për ruajtjen e saj. Në Lagunën e Vainit, specialistët e AdZM Lezhë, në bashkëpunim me nxënësit e Shkollës së Bashkuar “Ndoc Gjetja”, Klasa XII, zhvilluan një aktivitet mjedisor me 25 nxënës në kuadër të kësaj dite. Nxënësit vizituan Qendrën e Vizitorëve të Vainit, ku u njohën me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e zonës, si dhe vëzhguan nga afër faunën e egër përmes pajisjeve optike, duke përjetuar një eksperiencë të drejtpërdrejtë me natyrën.

14 Mars 2026 - Dita e Veprimit për Lumenjtë

Lumenjtë janë burime jetike për ekosistemet dhe komunitetet njerëzore, ndaj mbrojtja e tyre është thelbësore. Në Shkollën e Bashkuar “Ndoc Gjetja”, Klasa VII, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me 25 nxënës në kuadër të kësaj dite. Nxënësit u njohën me lumenjtë kryesorë të Shqipërisë dhe rëndësinë e tyre për jetën dhe natyrën, si dhe u angazhuan në një quiz edukativ mbi ujën si element jetik i planetit.

18 Mars 2026 - Dita Botërore e Riciklimit

Riciklimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve janë thelbësore për mbrojtjen e mjedisit. Në shkollën 9-vjeçare “Gjergj Fishta”, Klasa VI, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me 25 nxënës në kuadër të kësaj dite. Nxënësit u njohën me konceptet e reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit, si dhe morën pjesë në aktivitete kreative duke përdorur materiale të riciklueshme dhe duke përcjellë mesazhe ndërgjegjësuese për mjedisin.

fauna e egër habitat
mbjellje fidanësh orë mjedisore





21 Mars 2026 - Dita Botërore e Pyjeve

Pyjet luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në Tokë. Në shkollën 9-vjeçare "Zejmen", Klasa IV, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me 25 nxënës në kuadër të kësaj dite. Gjatë aktivitetit u diskutua rëndësia e pyjeve përmjedisin, klimën dhe jetën, duke nxitur ndërgjegjësimin për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.

22 Mars 2026 - Dita Botërore e Ujit

Uji është një burim jetik për jetën dhe ekosistemet, ndaj ruajtja e tij është përgjegjësi e përbashkët. Në Shkollën e Bashkuar "Karl Gega", Klasa VII, stafi i AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore me 25 nxënës në kuadër të kësaj dite. Nxënësit u njohën me burimet ujore dhe rëndësinë e tyre për biodiversitetin, si dhe ilustruan ciklin e ujit përmes aktiviteteve praktike dhe kreative.

30 Mars 2026 - Dita Botërore "Zero Mbetje"

Reduktimi i mbetjeve dhe menaxhimi i tyre janë thelbësore për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Në shkollën 9-vjeçare "Fran Ivanaj", Klasa VII, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me 25 nxënës në kuadër të kësaj dite. Nxënësit u njohën me klasifikimin e mbetjeve dhe ndikimin e tyre në mjedis, si dhe u angazhuan në aktivitete praktike dhe një pyetësor mbi reduktimin e mbetjeve.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



3 Mars 2026 - Dita Botërore e Jetës së Egër

Jetë e egër dhe biodiversiteti përbëjnë një pasuri të rëndësishme natyrore që kërkon mbrojtje dhendërgjegjësim të vazhdueshëm. Në shkollën 9-vjeçare “Qazim Zenel Tepshi”, Krujë, klasa V, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në kuadër të kësaj dite. Nxënësit u njohën me rëndësinë e specieve të egra dhe rolin e tyre në ekuilibrin natyror, si dhe realizuan punime krijuese me motive nga jeta e egër, duke forcuar lidhjen me natyrën.

12 Mars 2026 - Dita “Mbill një lule”

Lulet dhe gjelbërimi janë elementë thelbësorë për një mjedis të shëndetshëm dhe estetik. Në shkollën 9-vjeçare “Rinia”, Durrës, klasa VIII, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një aktivitet edukues dhe krijues me nxënësit në kuadër të Ditës së Luleve. Nxënësit krijuan vazo me materiale të riciklueshme dhe mbollën lule të ndryshme, duke kontribuar në zbukurimin e ambienteve të shkollës dhe ndërgjegjësimin për kujdesin ndaj natyrës.

18 Mars 2026 - Dita Botërore e Riciklimit

Riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve janë hapa thelbësorë për mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e ndotjes. Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Rrushkull” (klasa 6), ku nxënësit mësuuan mbi ndarjen e mbetjeve në burim, ndikimin negativ të tyre në tokë, ujë dhe ajër, si dhe u nxitën të kontribuojnë në ruajtjen e një mjedisi më të pastër në jetën e përditshme.

22 Mars 2026 - Dita Botërore e Ujit

Uji është një burim jetik për jetën dhe ekosistemet, ndaj ruajtja e tij është përgjegjësi e përbashkët. Në shkollën 9-vjeçare “Bajram Gashi”, Fllakë, klasa III, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit. Ata u njohën me rëndësinë e ujit, burimet ujore dhe problematikat e ndotjes dhe shpërdorimit të tij, duke u ndërgjegjësuar për përdorimin e kujdesshëm të këtij burimi jetik.

fauna e egër edukim mjedisor

ditë botërore natyrë



“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



[@akzm.gov.al](#) [@akzmalbania](#) [@akzmalbania](#) [@a_k_z_m](#)

Copyright AKZM All rights reserved

fauna e egër ndërgjegjësim park natyror

orë mjedisore ditë botërore

3 Mars 2026 - Dita Botërore e Jetës së Egër

Jeta e egër dhe ruajtja e biodiversitetit janë elementë thelbësorë për ekuilibrin e ekosistemeve natyrore dhe kërkojnë ndërgjegjësim të vazhdueshëm. Në shkollën 9-vjeçare “Hamdi Mancaku”, Zall Dajt, PKMD, me nxënësit e klasave VI-VII u zhvillua një orë mjedisore ku u trajtuar rëndësia e jetës së egër dhe rreziqet që e çenojnë atë. Nxënësit u angazhuan në aktivitete krijeseduke realizuar maska me kafshë të egra, si dhe u njohën në terren me metodën e monitorimit të faunës përmes kamerave kurth, duke kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së specieve në habitatet e tyre natyrore.

14 Mars 2026 – Ndërkombëtare e Veprimit për Lumenjtë

Lumenjtë përbëjnë një burim jetik për ekosistemet dhe komunitetet, ndaj mbrojtja e tyre është thelbësore. Në shkollën 9-vjeçare “Hamdi Mancaku”, Zall Dajt, PKMD, me nxënësit e klasave VII-IX, u zhvillua një aktivitet mjedisor përgjatë lumit të Tiranës në kuadër të kësaj dite. Nxënësit morën pjesë në pastrimin e zonës, duke u angazhuar aktivisht dhe duke përcjellë mesazhin e rëndësishëm të ruajtjes së lumenjve dhe mjedisit natyror.

18 Mars 2026 – Dita Botërore e Riciklimit

Riciklimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve janë thelbësorë për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjes. Në shkollën e Mesme të Bashkuar “Ymer Lala”, Surrel, specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një aktivitet mjedisor me nxënësit e klasës së 14-të. Ata u njohën me procesin e riciklimit dhe ndarjen e mbetjeve, ndërsa më pas realizuan një maket krijes me materiale të riciklueshme, duke përcjellë mesazhin mbi rrezikun e plastikës për jetën detare, veçanërisht për breshkat e detit.

22 mars 2026 – Dita Botërore e Ujit

Uji është një burim jetik për jetën dhe ekosistemet, ndaj ruajtja e tij është përgjegjësi e përbashkët. Në shkollën e Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”, Zall Bastar, PKMD, me nxënësit e klasës së VI u zhvillua një aktivitet mjedisor përgjatë lumit të Tërkuzës. Nxënësit u angazhuannë pastrimin e zonës nga mbetjet, duke kontribuar në mbrojtjen e burimeve ujore dhe duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e ujit të pastër.



“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



Parku Kombëtar “Shebenik” flora dhe fauna
edukim mjedisor zona të mbrojtura

3 Mars 2026 Dita Botërore e Jetës së Egër

Jeta e egër dhe biodiversiteti i Parkut Kombëtar “Shebenik” përbëjnë një pasuri të rëndësishmenatyrore që kërkon edukim dhe mbrojtje të vazhdueshme. Në Shkollën 9-vjeçare “Hajdar Kullafi”, Letëm, u zhvillua një orë mjedisore mbi Ditën Botërore të Jetës së Egër, e realizuar ngaspecialistë të AdZM Elbasan. Nxënësit u njohën me faunën e pasur të parkut përmesprezantimeve, vizatimeve dhe punëve krijuese, duke zhvilluar ndërgjegjësimit dhe lidhje më tëfortë me natyrën.

5 mars 2026- Fauna në Parkun Kombëtar Shebenik

Ruajtja e faunës dhe ekosistemeve natyrore është thelbësore për ekuilibrin mjedisor. Në Shkollën9-vjeçare “Daut Gurra”, Dragostunjë, u zhvillua një orë mjedisore në kuadër të Parkut Kombëtar“Shebenik”, e realizuar nga specialistë të AdZM Elbasan. Nxënësit u njohën me faunën e zonëspërmes prezantimeve dhe aktiviteteve krijuese, duke forcuar njohuritë mbi rëndësinë e mbrojtjessë natyrës.

11 mars 2026 - Aksion pastrimi

Ndërgjegjësimit për mjedisin dhe ruajtja e pastërtisë janë thelbësore për komunitete tëqëndrueshme. Në Shkollën 9-vjeçare “Zeqir Hunçi”, Gizavesh, pjesë e Parkut Kombëtar“Shebenik”, u zhvillua një aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe përreth saj. Nxënësit u angazhuan aktivisht në pastrimin e mjedisit, duke përcjellë mesazhin e përgjegjësisë dhe kujdesitpër natyrën.

12 Mars 2026 - Dita Botërore "Mbill një lule"

Bimët dhe lulet luajnë një rol të rëndësishëm në gjelbërimin dhe ruajtjen e mjedisit natyror.

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Ahmet Elezi", Stravaj, u zhvillua një orë mjedisore në kuadër të Ditës "Mbill një lule". Nxënësit u njohën me bimët dhe lulet e zonave të mbrojtura dhe u angazhuan në krijimin e mini-projekteve me lule, duke zhvilluar kreativitetin dhe ndjenjën përgjegjëse ndaj natyrës.

17 mars 2026 - Aktivitet pastrimi në RNM Dardhë-Xhyrë

Ruajtja e pastërtisë së mjedisit është një nga detyrat kryesore për mbrojtjen e zonave natyrore. Në Shkollën 9-vjeçare "Shaban Leka", Xhyrë, pranë Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Dardhë-Xhyrë", u zhvillua një aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe përreth saj. Nxënësit u ndërgjegjësuan për rëndësinë e mbajtjes së pastër të mjedisit dhe rolit të tyre në mbrojtjen e natyrës.

18 Mars 2026 - Dita Botërore e Riciklimit

Riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve janë thelbësorë për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Në Shkollën 9-vjeçare "Isuf Gjura", Kuturman, pranë Peizazhit të Mbrojtur "Kuturman-QafëBush", u zhvillua një orë mjedisore mbi rëndësinë e riciklimit. Nxënësit u njohën me procesin e riciklimit dhe realizuan punime krijuese, duke përcjellë mesazhe ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit.

25 mars 2026 - Vlerat natyrore të Parkut Kombëtar Shebenik

Parku Kombëtar "Shebenik" përfaqëson një pasuri të rëndësishme natyrore me biodiversitetin tepasur dhe habitate të veçanta. Në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Sali Halili", Rrajcë, u zhvilluan një orë mjedisore me fokus njohjen e vlerave natyrore të zonës. Nxënësit u angazhuan në aktivitete edukative dhe krijuese, duke realizuar materiale vizuale mbi faunën dhe habitatet, sidhe duke forcuar dashurinën për natyrën.

30 Mars 2026 - Dita Ndërkombëtare "Zero Mbetje"

Reduktimi i mbetjeve dhe menaxhimi i tyre janë thelbësorë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Isak Alla", Zgosht, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik", u zhvillua një aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe përreth saj. Nxënësit u angazhuan në mënyrë aktive, duke përcjellë mesazhin se mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi e përbashkët e komunitetit dhe brezave të rinj, aktivitet i realizuar nga specialistët të AdZM Elbasan.



“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



orë mjedisore ligatinat
gjelbërim park kombëtar

3 Mars 2026 - Dita Botërore e Jetës së Egër

Në kuadër të Ditës Botërore të Jetës së Egër, nxënësit e shkollës “Hasan Koçi” Durrës vizituan Qendrën e Vizitorëve në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta. Gjatë vizitës, ata u njohën me biodiversitetin e pasur të zonës, përfshirë shpendët, kafshët dhe bimët karakteristike, si dhe me rëndësinë e ruajtjes së habitateve natyrore.

12 Mars 2026 - Dita e Veprimit për Lumenjtë

Në kuadër të Ditës së Veprimit për Lumenjtë, specialistët e AdZM Fier zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme “Miti Zoi Zaka” në Divjakë. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së lumenjve dhe ekosistemeve ujore, rolin e tyre në natyrë dhe jetën e përditshme, si dhe me mënyrat praktike të kontributit për ruajtjen e tyre. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e burimeve natyrore.

25 mars 2026 - Orë mjedisore

AdZM Fier, në bashkëpunim me Shoqatën Horizont EU, zhvilloi një aktivitet edukues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Hysen Malko” në Kryekuq. Nxënësit u njohën me shtigjet e Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta dhe rëndësinë e tyre për eksplorimin dhe njohjen e natyrës. Një moment i veçantë ishte demonstrimi praktik i markimit të një shtegu në zonën e Gjenerukës, duke i përfshirë të rinjtë në mënyrë aktive në ruajtjen dhe promovimin e mjedisit.

26 – 27 mars 2026 - Vizitë studimore në kuadër të “Orës së Tokës”

Për dy ditë radhazi, nxënësit e Albanian College Tirana zhvilluan një vizitë studimore në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, ku u njohën me vlerat e rralla të biodiversitetit të zonës. Pranë Qendrës së Vizitorëve morën informacion mbi rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve, ndërsa më pas realizuan vrojtime të shpendëve në habitatet ujore të parkut. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të ndërgjegjësimit mjedisor “Ora e Tokës”, duke inkurajuar të rinjtë të kontribuojnë në mbrojtjen e planetit.



30 Mars 2026 - Orë mjedisore

Nxënësit e Shkollës Franceze, Tiranë vizituan Qendrën e Vizitorëve në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Gjatë vizitës, ata u njohën me biodiversitetin e pasur të zonës, përfshirë shpendët, kafshët dhe bimët karakteristike, si dhe me rëndësinë e ruajtjes së habitateve natyrore.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



fauna e egër habitate ditë botërore
zona të mbrojtura



3 Mars 2026 - Dita Botërore e Jetës së Egër

Dita Botërore e Jetës së Egër u shënuar përmes një ore edukimi mjedisor të zhvilluar nga AdZMKukës me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Sejdi Dida” Krumë. Gjatë aktivitetit u trajtuan rëndësia e ruajtjes së biodiversitetit, mbrojtja e jetës së egër dhe habitatet natyrore, si dhe kërcënimet që irrezikojnë ato. Nxënësit u angazhuan në diskutime mbi mënyrat konkrete të mbrojtjes së natyrës dhe rolit të tyre në këtë proces.

12 Mars 2026 -Dita Botërore “Mbjell një Lule”

Rëndësia e gjelbërimit dhe rolit të bimëve në mjedis u trajtuan në një aktivitet edukativ të zhvilluar nga AdZM Kukës me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Beslidhja e Malësisë”, Tropojë. Aktiviteti u fokusua në ndërgjegjësimin për kujdesin ndaj natyrës dhe vlerën e hapësirave të gjelbra. Nxënësit shprehën kreativitetin e tyre përmes punimeve artistike që lidhen me temën e natyrës.

18 Mars 2026 - Dita Botërore e Riciklimit


Në zonën “Këneta e Kashtës”, Monument Natyre në Kukës, AdZM Kukës organizoi një aktivitet pastrimi dhe ndërgjegjësimi mbi menaxhimin e mbetjeve dhe rëndësinë e riciklimit. U realizuapastrimi i zonës dhe sensibilizimi për mbrojtjen e mjedisit natyror. Aktiviteti kontribuoi në përmirësimin e gjendjes së zonës dhe rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor.

24 Mars 2026 – Dita Botërore e Ujit

AdZM Kukës zhvilloi një aktivitet edukues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Beslidhja e Malësisë”, Tropojë, ku u trajtua rëndësia e ujit si burim jetik, ruajtja e burimeve ujore dhe problematikat që lidhen me ndotjen dhe përdorimin e tij. Gjatë aktivitetit u theksua nevoja përsjellje të qëndrueshme në përdorimin e ujit në jetën e përditshme.



“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



edukim mjedisor fauna e egër
zona të mbrojtura



6 mars 2026 - Orë mjedisore

Në shkollën “Sotir Gurra”, klasa e 5-të, specialistët e AdZM Korçë realizuan një orë mjedisorembi zonat e mbrojtura në formë bashkëbisedimi. Gjatë aktivitetit u trajtuan parqet kombëtare, flora dhe fauna, si dhe rëndësia e ruajtjes së tyre. Në përfundim u zhvillua një fjalëkryq përpërforcimin e njohurive.

7 Mars 2026 - Festa e Mësuesit

Me rastin e Festës së Mësuesit, në shkollën “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” në Korçë, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një aktivitet kreativ me nxënësit e klasës së parë. Fëmijët përgatitënkartolina me materiale natyrore si gjethe dhe lule, të shoqëruara me mesazhe urimi dhefalënderimi për mësuesit.

12 Mars 2026 - Dita Botërore “Mbill një Lule”

Në Kopshtin nr. 5 në Korçë, grupi I duc I fëmijëve u angazhua në një aktivitet praktik mbimbjelljen e luleve, I realizuar nga specialistët e AdZM Korçë. Ata u njohën me procesin e mbjelljes dhe pjesët kryesore të bimës, duke e përjetuar aktivitetin në mënyrë ducative dhepraktike.

12 mars 2026 - Aksion mbjellje

Fëmijët e grupit të tretë të Kopshtit nr. 5 në Korçë morën pjesë në një aksion për mbjelljen e fidanëve në oborrin e institucionit, në bashkëpunim me AdZM Korçë. Aktiviteti u fokusua nëkujdesin për fidanët dhe njohjen me rëndësinë e gjelbërimit dhe mbrojtjes së mjedisit

31 mars 2026 - Orë mjedisore

Në bashkëpunim me Shkollën Teknike Profesionale Korçë, specialistët e AdZM Korçë finalizuan projektin "Kopshti Vertikal", një model inovativ i bujqësisë urbane dhe përdorimit të qëndrueshëm të hapësirës. Gjatë implementimit u realizua mbjellja e bimëve të ndryshme, duke e kthyer strukturën në një shembull praktik të edukimit mjedisor. Projekti synon zgjerimin dhe aplikimin në Qendrat e Informacionit të Parkut Kombëtar të Prespës si praktikë e mirë e zhvillimit të qëndrueshëm.



“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



3 Mars 2026 - Dita Botërore e Jetës së Egër

Me rastin e Ditës Botërore të Jetës së Egër, stafi i AdZM Vlorë zhvilloi një orë mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Balil Pelari” në Orikum. Gjatë aktivitetit u trajtua rëndësia e ruajtjes së biodiversitetit, duke u prezantuar edhe gjallesat karakteristike të Parkut Kombëtar Llogara dhe Parkut Kombëtar Karaburun–Sazan. Nxënësit u njohën me speciet e florës dhe faunës së zonës, si dhe me sfidat që lidhen me mbrojtjen e tyre. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e jetës së egër dhe rolin e secilit në mbrojtjen e saj. Nxënësit realizuan punime kreative duke ngjyrosur gjallesat e paraqitura në materialet e përgatitura.

26 mars 2026 - Orë mjedisore

Studentët e programit MSc në Planifikim Urban pranë Universitetit “Polis” zhvilluan një orë mjedisore në Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta, në kuadër të lëndës “Planifikim Mjedisor”.

Gjatë aktivitetit u trajtuan protokollat e monitorimit dhe planet e menaxhimit në zonat e mbrojtura, si dhe roli i planifikuesve urbanë në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Aktiviteti u fokusua në lidhjen mes teorisë dhe praktikës në menaxhimin e zonave natyrore të mbrojtura. Pjesëmarrësit u njohën edhe me përdorimin e instrumenteve teknike për monitorim në terren.

fauna e egër ndërgjegjësim

orë mjedisore breshka detare biodiversitet